

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Për: Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit: KOSTT-23-8255-2-1-1

Nr i brendshëm: KOSTT5329/12-23-05-211

Sa i përket tenderit për: Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara (oborreve) të Nënstacioneve 400, 220 dhe 110 kV

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“Qazim Durmishaj” B.I.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr, “Dëshmorët e Kombit”, Skenderaj

(Adresa)

Skenderaj

41 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 195 119

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Qazim Durmishaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

qazimdurmishaj@gmail.com

(Adresa elektronike)

26.09.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

- ✓ Njoftimi për kontratë i datës 04.08.2023.
- ✓ Dosja e tenderit e datës 04.08.2023.
- ✓ Procesverbali i hapjes i datës 30.08.2023.
- ✓ Njoftimi mbi vendimin e AK-se B-58, i datës 08.09.2023.
- ✓ Kërkesa për rishqyrtim e datës 13.09.2023.
- ✓ Vendimi i AK-se mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 13.09.2023.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					Jo	
----	--	--	--	--	----	--

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me

arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>		Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	----	--------------------------	--

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të Legjislacionit sekondar të KRPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pakenaqr me vendimin e Autoritetit Kontraktues Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A., te dates 08.09.2023 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara (oborreve) të Nënstacioneve 400, 220 dhe 110 kV me nr. te prokurimit: : KOSTT-23-8255-2-1-1 ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së, ushtrojme kete ankese prane OSHP-se:

Për shkak se AK- Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.,:

- ne mënyre te kundërligjshme e ka rekomanduar per kontrate nje operator ekonomik i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

Sqarojmë ne mënyrë të detajuar:

Autoriteti Kontraktues Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A., me datën 08.09.2023 ka Publikuar njoftimin B58 ku ka rekomanduar per kontrate Operatorin Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K i cili operator nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT, te pa kënaqur me kete vendim, me date 13.09.2023 kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim pranë AK-se dhe te njeten dite me datën 13.09.2023 AK na kthen përgjigje ku kunderligjeshem na refuzon kërkesën tone per rishqyrtim.

Autoriteti Kontraktues ne NJK dhe DT ka kërkuar tek:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:

Një (1) kontratë në lidhje me shërbimet ngjashme, me kompleksitetit përafërsisht të njëjtë, e përfunduar në 3 vitet e fundit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

-Një listë që specifikon parimet relevante të performancës që specifikon; shërbimet e ngjashme; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin, -Të dëshmuara me 1 certifikatë të pranimi apo 1 referencë për shërbimet apo punë të ngjashme, përgjatë tri viteve te fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontrate, (kositje të barit apo të ngjashme) të realizuara nën stabilimente te tensionit të lartë. Projekt me kompleksitet të njëjtë konsiderohet projekti i implementuar në institucione të sektorit te energjisë, siç janë KOSTT, KEK, KEDS dhe te gjithë prodhuesit

privat të energjisë elektrike.

Pra sic shihet se ky aktivitet i prokurimit eshte shërbim dhe shume qarte dihet prej numrit te prokurimit KOSTT-23-8255-2-1-1 dhe AK ka kërkuar pet kete aktivitet te prokurimit nje kontrate ne lidhje me shërbimet e ngjashme, me kompleksitet përafërsisht te njejte ku si dëshmi ka kërkuar nje reference per shërbime apo pune te ngjashme, përgjatë tre viteve te fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate (kositje e barit apo te ngjashme). Operatori Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K nuk e ka asnjë reference te ndonjë shërbimi te ngjashëm, edhe pse AK ka thene ne pergjigjen mbi kërkesën per rishqyrtim se kemi kërkuar pune te ngjashme por ne kete rast as pune te ngjashme nuk ka vetëm po e dokumentojmë me prova nëse e shikojmë paramasen e kesaj kontrate me paramasen e kontratets se prezantuar nga Operatori Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K.

Pra AK e ka marre per baze ne pergjigjen e kërkesës tone per rishqyrtim, kete kontrate te Operatorit Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K. pra sipas AK-se Operatori Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K. e plotëson kërkesën e AK-se me kete kontrate:

1. DESHISHKU GB SH.P.K., 810007460

2 Referenca me KOSTT

- Rehabilitimi i themeleve te shtyllave ne linjat 110kV, 220kV dhe 400kV
- Rehabilitimi i bazamenteve te betonit ne shtyllat e linjave 400kV, 220kV dhe 110kV

Ndërsa ne liste Operatori Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K.e ka prezantuar kete kontrate si me poshtë:

Operatori Sistemi Transmisioni dhe Tregu sh.a. (KOSTT sh.a.)	Rehabilitimi i themeleve të shtyllave në linjat transmetuese 400 220 110kV	KOSTT-19-9631-5-2-1	27.02.2020	Në gjithë territorin e Kosovës	25.09.2020	17,276.38 €	17,276.38 €
---	--	---------------------	------------	--------------------------------	------------	-------------	-------------

Nëse e shikojmë specifikacionin e këtij tenderi dhe përshkrimin e punëve kemi si me poshte:

3. Përshkrimi i punëve

Fushëveprimtaria kryesore e Operatorit ekonomik ka të bëjë me:

- Riparimin dhe rehabilitimin e bazamenteve nga betoni

Pjesa e dizajnit

- Operatori ekonomik ka për obligim që ne oferten teknike të paraqesë dizajnin (me formen dhe permasat e themeleve të nevojshme për riparim).
- Menyren-metodologjinë e riparimit duke ofruar të dhëna të mjaftueshme se si do të bëjë ndërhyrjet në riparimet e kërkuara.

Pjesa e realizimit të punimeve:

- Identifikimi i rrugëve për qasje deri te shtylla (ne do ti ndihmojmë në këtë proces).
- Rregullimi i terenit dhe pershtatja për punë.
- Krijimi i kushteve për punë të sigurt për njerzit, linjen, dhe makinerit qofshin ato, të pronarëve të rrjetit, pronarëve të pronave apo edhe puntorëve të tyre.
- Germimi i dheut –hapja rreth bazamenteve të ankerit të shtylles.
- Punimi nga armaturat e qelikut Ø10mm të një mbështjellsesi si perforcimin e struktureve të bazamentit.
- Rilidhjen e sistemit të tokëzimit në pikat ku është i vendosur.
- Të bëhet matja e rezistencës së tokëzimit dhe të dorëzohet elaborati me matjet e kryera (aty ku është i shkeputur).
- Permiresimin e terenit, pastrimi rreth shtylles nga inertet dhe permiresimi i dheut rreth bazamentit.
- Të bëhet ngjeshja e dheut afër bazamentin pas perfundimit.
- Të bëhet ngjyrosja e bazamentit me material epoxid në bazamentet e rindertuara.
- Punime tjera të nevojshme për kompletimin e këtij projekti në tërësi.

Ndërsa nëse e shikojmë specifikacionin e tenderit për et cilin po e paraqsim këtë ankese pranë OSHP-se dhe që po e argumentojmë me prova që nuk janë tenderë të nejtë as të ngjashëm kemi :

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit
1.	Kositja e barit
2.	Grumbullimi i barit
3.	Bartja e barit jashtë nënstationit
4.	Spërkatja me herbicide të hapësirave të mbuluara me zhavor

Pra asnjërin nga këto pozicione nuk e posedon kontrata që e ka prezantuar Operatori Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K.

Pra shihet qarte se kemi të bëjmë me dy aktivitete të ndryshme të prokurimit dhe që nuk janë të ngjashme, kurse AK ne kërkesën e vet ka vendosur që: Një (1) kontratë në lidhje me shërbimet ngjashme, me kompleksitetin përafërsisht të njëjtë, e përfunduar në 3 vitet e fundit.

Pra shihet qarte se kjo nuk është kontratë e ngjashme dhe nuk është me kompleksitet të njëjte kjo dallon si tek numri i prokurimit që aktiviteti për Rehabilitimi i themeleve të shtyllave në linjat transmetuese 400 220 110kV me numër të prokurimit KOSTT-19-9631-5-2-1 ndërsa Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara (oborreve) të Nënstacioneve 400, 220 dhe 110 kV me nr. të prokurimit : KOSTT-23-8255-2-1-1 nga numrat shihet qarte se njëra është punë e tjetra është shërbim.

Shihet qarte se kemi të bëjmë me dy kontrata të ndryshme të natyrës së ndryshme dhe që për implementimin e tyre duhet pasur komplet mjete të ndryshme të punës. Pra duhet përgaditje e veçantë profesionale e ndryshme për të implementuar këto kontrata. Autoriteteve kontraktuese kur po ju konvenon vetëm numrin e prokurimit me i dallue po na eliminojnë prej aktiviteteve të prokurimit.

Siç po shihet me lartë AK e ka rekomanduar për kontratë kundërligjshëm Operatorin Ekonomik DESHISHKU GB SH.P.K. në këtë aktivitet të prokurimit pasi nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së ndërsa neve jemi të vetmit që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura në NJK dhe DT pra kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm dhe me Çmimin më të ulët.

Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së ku në piken 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe në piken 2 thuhet : *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të*

prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit dhe me Çmimin më të ulët, Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga OSHP që ta detyroj AK-ne që ti respektoj në përpikëri dispozitat ligjore që janë në fuqi lidhur me këto lloje të aktivitetit të prokurimit dhe të nxjerr:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik: "Qazim Durmishaj" B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara (oborreve) të Nënstacioneve 400, 220 dhe 110 kV me nr. të prokurimit : KOSTT-23-8255-2-1-1 të iniciuar nga AK- Oper. Sistemi, Trans. dhe Tregu- KOSTT SH.A., , dhe **II. ANULOHET** njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas rivlerësimit të shpallemi fitues i këtij aktiviteti të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si në përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim ashtu edhe për përgatitjen e ankesës. Dëmi refletkon në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe

- të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.